■ **Në pamjen kryesore të prerjes 50 Lekë**, është mozaiku "Bukuroshja e Durrësit" i cili është kufizuar me harqe anësore, motive floreale të stilizuara, marrë nga ky mozaik. Në harkun e monedhës janë paraqitur motive dekorative (rrathë simetrik) të marra nga periudha ilirike, të cilat shkojnë në harmoni me pamjen në qendër të monedhës.

■ **Në pamjen pas**, në qendër është paraqitur një krijim dekorativ, me motive floreale marrë nga mozaiku "Bukuroshja e Durrësit". Kjo figurë shoqërohet me rrathë deri në harkun e monedhës. Në hark lart ka të shkruar "SHQIPËRI- ALBANIA 2004".

■ **The front view of the 50 Lek** issue displays the mosaic "The Belle of Durres", surrounded by flower arches motives taken by this mosaic. The rim of the coin shows decorative motives (symmetric circles) take from the Illyrian period, which are in good harmony with the view in the center of the coin.

■ **The backside displays flowery** decorations taken from the mosaic "The Belle of Durres". This figure is followed by circles down to the rim of the coin. "SHQIPËRI- ALBANIA 2004" is written above in an arch-like shape.



**Bank of Albania / Banka e Shqiperise**
"Skenderbeg" Square, No 1
Tirana
ALBANIA
tel./fax +555 4 235574, fax +355 4 223558





## *Përshkrimi për vizatimin e monedhës me tematikë "Antikiteti shqiptar"*

(MOZAIKU "BUKUROSHJA E DURRËSIT)

## *Theme of the coin: "Albanian antiquity"*

("THE BELLE OF DURRËS" MOSAIC)

# *Mozaiku i bukuroshes së durrësit*

Për herë të parë ky mozaik u zbulua rastësisht gjatë punimeve të ushtrisë austriake për krijimin e një fortifikate në vitin 1916. Oficeri austriak i cili qe dhe një arkeolog i shquar i quajtur Camillo Prashnicher (Kamillo Prashniker), u kujdes që shtresa e mozaikut të rruhej për të mos u prishur. Ai është i pari që e botoi fotografinë e mozaikut në një libër të tij arkeologjik për Shqipërinë dhe e quajti një kryevepër figurative të artit helenistik. Më pas mozaiku u mbulua dhe humbi. Për fat të mirë në 1947 arkeologu i Durrësit Vangjel Toçi e rizbuloi. Mozaiku ndodhej në thellësinë 3.80m në themelet e një shtëpie në qendër të qytetit. Sipërfaqja e mozaikut rrethohet nga një bordurë muri dhe ka formë eliptike dhe ze një sipërfaqe afro 9 m2. Në qendër të mozaikut është figura e një femre të re dhe të bukur mes një peizashi plot kërcej lulesh, gonxhesh dhe petalesh. Mozaiku i mbiquajt si "Bukuroshja e Durrësit", emër ky konvencional e metaforik. I takon si kohë fundit të shekullit IV para Krishtit. Ky mozaik ka zbukuruar një banjë private, luksoze, në këtë lak kohor në Durrës. Teknika e Mozaikut është me gurë zalli natyrorë me ngjyra të ndryshme të ngjitura me njëra tjetrën me mjeshtëri shumë të madhe sipas teknikës opus – vermiculatum. Ky mozaik sendërton një art të zhvilluar dhe ka lidhje stilistikore me mozaikët e Pelas të së njëjtës kohë në Maqedoni. Në vitin 1982 mozaiku u zhvendos nga Durrësi dhe u vendos në sallën kryesore të Antikitetit në Muzeun Historik Kombëtar. Identifikimin e figurës së mozaikut për herë të parë e bëri arkeologu Dr. Moikom Zeqo i cili vuri në dukje se vajza e figuruar është e njëjtë me atë të arketipeve të amforave të pikturuara të Apulisë dhe të Italisë së Jugut, me figura të kuqe të epokës helenistike. Sipas Dr Zeqos kjo femër përfaqëson hyjneshën Eylithea e cila ndihmon lindjen e shëndetshme të fëmijëve. Ky është mozaiku më i shquar dhe më i lashtë i gjetur në Shqipëri.




| | |
|---|---|
| Prerja: | 50 Lekë |
| Materiali dhe pastërtia: | CU75 Ni25 |
| Pesha: | 5,50 gr |
| Diametri: | 24,25 mm |
| Forma: | e dhëmbëzuar |
| Ngjyra: | e bardhë |
| Tirazhi: | 200.000 copë |




| | |
|---|---|
| Issue: | 50 Lekë |
| Material and purity: | CU75 Ni25 |
| Weight: | 5,50 gr. |
| Diameter: | 24,25 mm |
| Edge: | serrated |
| Color: | white |
| Total quantity (in pieces): | 200.000 |

# *The belle of durres mosaic*

The mosaic was quite unexpectedly discovered, for the first time, by an Austrian army setting up a fortification in 1916. The Austrian officer, Camillo Prashnicher being also a good archeologist, took care of the mosaic so that it couldn't be damaged. He was the first to publish the mosaic picture in a book of his on Albanian archeology, and he referred to it as a masterpiece of the Hellenistic art. But later the mosaic was covered again and was lost.

Fourtunately, in 1947 it was re-discovered by the famous archeologist from Durres, Vangjel Toçi. The mosaic was discovered 3.80m beneath a dwelling, in a residential quarter of the town. It is surrounded by a wooden border, elliptical in shape and measures 17 x 10 feet. The mosaic shows a woman's head surrounded by flowers. The mosaic nicknamed as "The Belle of Durres" – a conventional and metaphorical name – belongs to the end of the IV century BC.

This mosaic was used to decorate a private, luxurious bath in this time span. The Belle of Durres, the most polychromatic mosaic found in the country, is made of pebbles put together after the opus - vermiculatum technique. It represents a high-developed fine art and has stylistic affinities with Pela's mosaics of the same period in Macedonia. In 1982, the mosaic was taken from Durres and placed in the main antiquity room of the National Historical Museum. Dr. Moikom Zeqo was the first to identify the mosaic figure, and he brought forth the fact that the woman designed is the same as the archetypes of the painted amphora of Apulia and South Italy, in red figures of the Hellenistic era. According to Dr. Zeqo, this woman represents Eileithyia the goddess of birth-pain. This is the most distinguished and old mosaic discovered in Albania.